



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/103

Datë: 21.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit për vitin 2013-2017.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë dhe Planin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/103
Datë: 21.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja e Punës së Komisionit Qeveritar për të drejtat e ish të burgosurve, të ish të dënuarve e të ish të përndjekurve politikë.
2. Obligohet Komisioni Qeveritar për të drejtat e ish të burgosurve, të ish të dënuarve e të ish të përndjekurve politikë Ankesa në procedurën e verifikimit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/103

Datë: 21.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THIAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/103

Datë: 21.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 29 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 60,000.00 (gjashtëdhjetë mijë) euro, që me rastin e Njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, të ribotohen veprat e simbolit të rezistencës z. Adem Demaçi.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga:
 - 2.1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 30,000.00 (tridhjetë mijë) euro nga kodi organizativ 208, programi 91900 dhe
 - 2.2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 30,000.00 (tridhjetë mijë) euro nga kodi organizativ 12424, programi 802.
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi barten në xhirollogarinë e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, nr. 1701001010330195, në bankën komerciale NLB.
4. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/103

Datë: 21.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 29 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjete financiare në vlerë prej 1,050,000.00 (një milion e pesëdhjetë mijë) euro për anëtarësim në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Thesar dhe nga Thesari barten në BERZH.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/103

Datë: 21.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor 2012, mori:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Qeverisë nr. 03/58 të datës 27.01.2012

1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi i Qeverisë nr. 03/58 të datës 27.01.2012, si në vijim: "nënparagrafi 1.1. zëvendësohet me Agim Çeku, Ish Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Kryesues dhe nënparagrafi 1.11. zëvendësohet me Ahmet Daku, Ish Z.O.K e UÇK-së"
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë